REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË DURRËS
Nr. 2076 Rep.
Nr. 940 Kol.

PULLE TAKSE
50 LEKE

# AKT THEMELIMI
# I
# SHOQËRISË AKSIONARE

## "Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008" SH.A

Sot, më datë 29/09/ 2008, përpara meje Skënder T. Gjoci, noter pranë Dhomës së Noterisë Durrës, me seli në lagjen nr. 4, Kavajë u paraqitën me cilësinë e aksionerëve themelues:

- *Shoqëria LUSHA L.S.A sh.pk, person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr: 30716, datë 22.12.2003, me seli të regjistruar në Luz të Vogël, Kavajë, sipas vullnetit të shprehur në Vendimin e Ortakëve të datës 14.09.2008 dhe e përfaqësuar po sipas këtij Vendimi nga administratori Lavdrim LUSHA , shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.10.1969, lindur në Luz të Vogël dhe banues në Luz të Vogël, person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.Z0780182,*

*dhe*

- *Komuna Luz i Vogël, e përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit të Komunës, të datës 24.09.2008 nga Kryetari i saj Z. Hajrulla Tafa, shtetas shqiptar, i datëlindjës 03.02.1966, lindur në Durrës dhe banues në fshatin Luz i Vogel s, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.Z0327321,*

kanë vendosur krijimin e shoqërisë **"Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008" Sh.a** me termat e mëposhtme:

### NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare **"Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008" sh.a** në formën e një Shoqërie Aksionare me oferte private. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë Shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **"Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008" sh.a.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

### NENI 2
### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit sportiv, kryesisht në atë të futbollit, rritja e vlerave sportive për sportin e futbollit në Komunën Luz i Vogël duke zbuluar elementë të talentuar dhe përgatitja e tyre si kontingjent për ekipin e Luzit të Vogël dhe për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

### NENI 3
### Emri, logo dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **"Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008" sh.a.**
Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.

### NENI 4
### Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Organizimi i aktiviteteve sportive në Komunën e Luzit të Vogël, kryesisht në sportin e futbollit, por edhe për lloje të tjera sporti.
- Krijimi i ekipit të parë te futbollit **Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008**, dhe ekipeve zinxhir si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga federata shqiptare.
- Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit.
- Aktivitete të tjera në fushën e sportit për interesat e shoqërisë dhe Komunës.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.
Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licensat apo lejet përkatëse.

### NENI 5
### Selia e Shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

Selia e Shoqërisë do të jetë në fshatin Luz i Vogël, pranë mjediseve të fushës së futbollit të këtij fshati.

Veprimtaria e shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Administratorit të saj.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

PULLE TAKSE

## NENI 6
## Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 lekë.

Ai është i ndarë, në 2 000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1 000 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 2 000 aksione.

Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare "**Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008**" sh.a zotërojnë aksionet në këtë Shoqëri si më poshtë:

1. Shoqëria "LUSHA L.S.A" sh. p. k, zotëron 95% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1900 numër aksionesh, me vlerë 1.900.000 lekë.
2. Komuna LUZ I VOGËL, zotëron 5% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë të barabartë me 100 numër aksionesh me vlerë 100.000 lekë.

## NENI 7
## Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i aksionarëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 2 000 000 lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë me oferte private. Aksionarët kanë derdhur masën prej ½ të kapitalit. Shuma e mbetur do të shlyhet në një ose më shumë këste sipas një vendimi të organit të administrimit të shoqërisë sipas nenit 113 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, brenda një afati një vjeçar.

Kapitali i Shoqërisë është depozituar në Bankën "TIRANA BANK" me seli në Kavajë në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë bankës "TIRANA BANK". Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria "Fondi themeltar i aksionarëve", ku regjistrohet vlera e kapitalit të tyre.

## NENI 8
## Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Këshilli Mbikqyrës – organ i mbikqyrjes;
3. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

## NENI 9
## Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

1. Z. Albert Lusha shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 shtator 1976, lindur në Luz të Vogël, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0756207;
2. Z. Sokol Lusha, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13 shtator 1970, lindur në Durrës, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z0327182;
3. Z. Petrit Lusha, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01 janar 1943, lindur në Luz të Vogël dhe banues po aty, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 1656583
4. Z. Feride Lusha, shtetase shiptare, e datëlindjes 02 janar 1945, lindur në Lekaj dhe banues në Luz të Vogël, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. Z 1656582;
5. Z. Hajrulla Tafa, shtetas shqiptar, i datëlindjes 03 shkurt 1966, lindur në Durrës dhe banues po aty, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0327321.

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

## NENI 10
## Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një afat 3 vjeçar.

Administatori i parë i i Shoqërisë Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008 sh.a. është Z. Lavdrim Lusha, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04/10/1969, lindur në Luz të Vogël të Kavajës dhe banues po aty, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0780182.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Admintratori i saj Z. Lavdrim Lusha, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 11
## Ekspertët Kontabël

Ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjet në fuqi dhe për çdo vit financiar të ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë. Shoqëria do të ketë një ekspert kontabël. Eksperti i parë kontabël do të jetë Z. Elez Lala me nr Liçense 75.

### NENI 12

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

### NENI 13.

Aksionari detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

### NENI 14.

Aksionari themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkurues me atë të shoqërisë **Klubi Futbollit LUZ I VOGËL 2008 sh.a**

### NENI 15.

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

### NENI 16.

Akti i themelimit pasi u gjet sipas vullnetit të përfaqësuesit te aksionarit themelues dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e tij para noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

**AKSIONERËT E SHOQËRISË**

**LUSHA L.S.A sh.p.k**
Përfaqësuar nga

**Lavdrim LUSHA**

LUSHA
L.S.A+SH.P.K
LUZI-VOGËL
KAVAJ

**KOMUNA LUZ I VOGËL**
Përfaqësuar nga

**Hajrulla TAFA**

**NOTER**

**Skënder T. GJOCI**



PASAPORTE
PASSPORT

REPUBLIKA E SHQIPERISE / REPUBLIC OF ALBAN

Tipi/Type
P

Kodi/Code
ALB

Nr.Pasaportes/Passport No.
Z0327321

Mbiemri/Surname
TAFA

Gjatesia/Height
164CM

Emri/Name
HAJRULLA

Gjinia/Sex
M

Shtetesia/Citizenship
ALB

Syte/Colour of eyes
KAFE

Datelindja/Date of birth
03 FEB/SHKU 1966

Vendlindja/Place of birth
DURRES

Autoriteti leshues/Authority
MRP

Nr.Personal/Perso
11270303005701

Data e leshimit/Date of issue
04 JAN/JAN 2003

Data e skadimit/Date of expiry
03 JAN/JAN 2013

Firma e mbajtesit/Holder's signature

```
P<ALBTAFA<<HAJRULLA<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<
Z0327321<3ALB6602037M13010361127030300570180
```



PASAPORTE
PASSPORT

**REPUBLIKA E SHQIPERISE / REPUBLIC OF ALBANIA**

Tipi/Type
P

Kodi/Code
ALB

Nr.Pasaportes/Passport No.
Z0780182

Mbiemri/Surname
LUSHA

Gjatesia/Height
160 CM

Emri/Name
LAVDRIM

Gjinia/Sex
M

Shtetesia/Citizenship
ALB

Syte/Colour of eyes
KAFE

Datelindja/Date of birth
04 OCT/TETO 1969

Vendlindja/Place of birth
LUZI VOGEL

Autoriteti leshues/Authority
MRP

Nr.Personal/Personal No.
11270403005801

Data e leshimit/Date of issue
12 DEC/DHJE 2003

Data e skadimit/Date of expiry
11 DEC/DHJE 2013

Firma e mbajtesit/Holder's signature
LAVDRIM LUSHA

```
P<ALBLUSHA<<LAVDRIM<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<
Z0780182<1ALB6910044M131211511270403005801 04
```